



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

**Raporti**  
**mbi trajtimin e ankesave dhe**  
**sugjerimeve të sipërmarrjes**  
**për muajin nëntor 2020**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA**

**MINISTËR SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES**

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në vijim të komunikimit me ju, në rolin e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me qëllim përditësimin tuaj mbi punën e bërë gjatë këtij muaji, kam kënaqësinë të ndaj me ju raportin e muajit nëntor 2020 si dhe trajtimin e ankesave në kuadër të njoftimeve periodike.

Krahas vizitave të vazhdueshme në biznese për t'u njohur nga afër me tipologjinë e problematikave të hasura më shpesh nga sektori i biznesit si dhe për të marrë sygjerime apo kërkesa me të cilat mund të lehtësojmë punën dhe zhvillimin e mëtejshëm të bizneseve, gjithashtu gjatë këtij muaji kam ndjekur edhe një sërë aktiviteteve me synim përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.

Një organizim me shumë vlerë ishte takimi virtual me Sparkassenstiftung, Grupi i Financave Për Bashkëpunim Ndërkombëtar. Gjatë këtij takimi diskutuam mbi forcimin e kulturës financiare në Shqipëri. Ky grup ka fokus kryesor përmirësimin e kushteve socio-ekonomike nëpërmjet ofrimit të programeve trajnuese për forcimin e njohurive rreth sigurisë financiare, që patjetër janë elementë të rëndësishëm për forcimin e këtij sektori, një bashkëpunim i cili do na ofrojë perspektiva të reja.

Me shumë kënaqësi organizuam së bashku me Akademinë e Shkencave, eventin e parë të NanoAlb, Njësia Shqiptare e Nanoshkencës dhe Nanoteknologjisë. Një takim i frytshëm që bëri bashkë botën akademike, biznesin dhe qeverinë në funksion të një bashkëpunimi që besojmë do të hap një prespektivë të re duke prezantuar nanoshkencën

në shërbim të biznesit dhe shoqërisë në përgjithësi. Motivuese pjesëmarrja e shumë bizneseve Shqiptare të cilat prezantuan si kërkimet e tyre shkencore por edhe nevojat e mëtejshme për të cilat nevojitet krijimi i urave të mëtejshme të bashkëpunimit.

Në javën e Liderëve Ekonomik të Mesdheut, Medaweek Barcelona çdo vit organizon një sërë forumesh me qëllim trajtimin e temave të lidhura me sektorët kyç të ekonomisë dhe vlerat kulturore të rajonit. Isha i nderuar të isha pjesë e këtij forumi, për të diskutuar mbi ekosistemin e startup-eve si dhe për të ndarë eksperiencën tonë në përgatitjen e ligjit si dhe të strategjisë për mbështetjen e inovacionit. Eksperiencia e vëndeve më të zhvilluara evropiane, në bashkëpunim me shoqatat dhe Dhomat e Tregtisë së Mesdheut, si dhe ekspertët e kësaj fushe të ftuar në këtë forum, krijuan mundësi të reja për shkëmbim idesh si dhe projekte të mëtejshme për të promovuar rajonin e Mesdheut.

Muaji nëntor shënoi gjithashtu edhe shumë takime me përfaqësues të ndryshëm lidhur me konsultimin publik të projektligjit për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve inovative. Faza e parë përfshiu konsultimet me ekosistemin në bashkëpunim me EU for Innovation ku vumë re një pjesëmarrje të gjërë si dhe komente e sygjerrime të vlefshme nga këto aktorë të spikatur të kësaj industrie të re. Së bashku me Këshillin e Investimeve organizuam gjithashtu një event konsultativ që synonte diskutimin e projektligjit të startup-eve inovative me dhomat dhe shoqatat e tregtisë si dhe ekspert ligjor dhe ekonomik të cilët na ofruan kritikën dhe vlerësimet e tyre lidhur me draftligjin.


Duke shprehur në vijimin e komunikimit me ju, shpreh bindjen time të thellë se nëpërmjet bashkëpunimit ne mund të përmirësojmë klimën e të bërit biznes në vendin tonë.

Me konsideratën më të lartë,

Eduard Shalsi

# Analiza e Ankesave Nëntor 2020

## 1. Statusi i ankesave dhe trajtimi i tyre



## 2. Statusi dhe shpërndarja e ankesave sipas ministrive

